



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	31.12.2025	09.01.2026	2025/1258

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.12.2025, OE “Ermal Sylaj B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1258, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajtja e rrugeve me zhavorr ne Komunen e Shtimes” me nr. të prokurimit: "617-25-8164-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2025/1063** i dt: 20.11.2025. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi (LPP)

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (LPP)

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës (LPP)

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale (LPP)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 04.12.2025 kemi pranuar B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e që sipas Autoritetit Kontraktues (AK) jemi eliminuar nga gara me arsyetimin se: Ju mungojnë

1. Pika c - Ngarkues me goma max 5 ton, minimumi 1 copë

Operatorit i mungon librezë valide dhe dokumentet përcjellëse për paisjen e kërkuar

2. Pika d - Greder min 14 - 16 ton min. 1 copë

Operatorit i mungon librezë valide dhe dokumentet përcjellëse për paisjen e kërkuar

AK me datë 24.11.2025 përmes sistemit eprokurimi ka kërkuar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit (sjellja dëshmime) e që në këtë kërkesë janë kërkuar sqarim për këto dy paisje.

Të pa kënaqur me njoftimin e dates 04.12.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna Shtime në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, konsiderojmë se në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT).

AK për plotësim kriteri ashtu dhe në Dëshmia e kërkuar dokumentare ka bërë lëshime të vogla teknike e që këto lëshime teknike e bëjnë të pamundur dëshminë sipas kërkesave dhe nëse këto lëshime teknike i keni lënë të vetëkuptueshme nga OE, atëher, është mëse e kuptueshme se Makineria e Rëndë ndërtimore në Republikën e Kosovës nuk dëshmohet me dokument të regjistrimit por me DUD Doganor ose Faturë (bazuar në praktikën e AK të tjerë në Kosovë).

Si fillim AK ka kërkuar që:

Nga pika (a-e) të dëshmohen me dokument të regjistrimit. A mund ta specifikoni se ku është pika "e" tek pjesa e "Mundësi teknike dhe profesionale" siç ju e keni emërtuar. A është "lëshim teknik", apo është e kuptueshme se pika "e" duhet të gjindet diku aty.

Tek kërkesat e "Mundësi teknike dhe profesionale" për pikën j. Rul per ngjeshje te dheut min 13t min 1 copë dhe për pikën k. Cilinder min 5. min 1 NUK është kërkuar fare "Dëshmia e kërkuar dokumentare". A është edhe ky "lëshim teknik" sepse janë kërkuar të dëshmohen vetëm pikat nga (f-I).

Bazuar në këtë si më sipër, si tek kërkesa e "Mundësi teknike dhe profesionale" ashtu dhe "Dëshmia e kërkuar dokumentare" kanë gabime teknike që e bëjnë të pamundur plotësimin e këtij kriteri.

Në lidhje me eliminimin për dëshminë e paisjeve ju sqaroj se:

a. Për sqarimin e kërkuar për paisjen për pikën c. Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë ju sqaroj se:

Ne me rastin e tenderimit kemi dëshmuar se i posedojmë 2 ngarkues sipas kërkesës specifike të makinerisë: 1. Kramer Allrad Radler 308/318 pronë e anëtarit të konzorciumit dhe 2. Gehl - 4610 dhe ky pronë e anëtarit të konzorciumit. Keto paisje ndërtimore, ashtu si dhe paisjet tjera ndërtimore në Kosovë vihen në punë pa Libreza të Qarkullimit, sepse nuk janë paisje që qarkullojnë në rrugë por vetëm në vendpunishte, dhe deri aty transportohet me Rimorkio adekuate për transport.

b. Ne lidhje me kërkesën sipas Letër Standarde për sqarimin e tenderit për pikën d. Greder min 14-16ton min. 1 copë ju sqaroj se:

Ne me rastin e tenderimit kemi dëshmuar se i posedojmë 1 Greder sipas kërkesës specifike të paisjes: 1. CATERPILLAR 12G (paisje kjo e huazuar nga MIRUSHA). Kjo paisje ndërtimore, ashtu si dhe paisjet tjera ndërtimore në Kosovë vihen në punë pa Libreza të Qarkullimit, sepse nuk është paisje që qarkullojnë në rrugë por vetëm në vendpunishte, dhe deri aty transportohet me Rimorkio adekuate për transport.

Pra, për këto 2 paisje ne kemi dorëzuar dëshmi të cilat kërkohen standard bazuar në praktikat e AK të tjerë në Kosovë.

Përfundim

Ju si AK mund të bazoheni në Paragrafin 4 të Nenit 59 të LPP-së, citoj "**autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.**"

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe

të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat standarde dhe kemi ofertuar me tenderin me çmim më të ulët.

Prandaj bazuar në provat deshmitë dhe argumentet e sipër përshkruara, kërkojmë nga AK që të ndërmarr verpimet ligjore dhe të aprovohet Ankesa jone në tërësi dhe të merret:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e kompanisë sonë.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit, në të kundërtën nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional	Kërkesa 5. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit, a. Kamion kiper me kapacitet min 15ton min. 2 cope c. Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë d. Greder min 14-16ton min. 1 copë f. Eskavator min 20ton min 2 copë g. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë h. Eskavator me zingjir gome min 8-10ton min 1 copë i. Eskavator me zingjir gome deri Iton min. 2 copë j. Rul per ngjeshje te dheut min 13t min 1 copë k. Cilinder min 5. min 1, Deshmia 5. Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si deshmi kopjet e dokumentit te regjistrimit per mjetet nga pika (a-e) dhelibreza, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I). Ne rast se OE nuk posedon paisjet mbi pronesine duhet te ofroje marreveshjen per marrjen me gira te paisjeve. Marreveshja duhet te jete ne emer te ketij projekti me validitet dhe kohezgjatje te kesaj kontrate e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palet.
---	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

 	
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA SHTIME OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME	
NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES <i>Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik</i>	
Titulli i kontratës :	
Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes Ri-vlersim	
Nr. i prokurimit¹	617-25-8164-2-2-1
Nr i brendshëm	617-2025-080 221
Rezultati i aktivitetit të prokurimit:	
Anulohet kjo procedur e prokurimit pasi që OE të cilët kanë konkuruar në këtë aktivitet nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit .	
Emri dhe mbiemri i ZPP: Muhadin Halili  	Data: 04.12.2025

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/1063 i dt:20.11.2025.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Ermal Sylaj B.I.**

Autoriteti Kontraktues Komuna Shtime gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 70,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP (kundër dhënies së kontratës), ku OE “Ermal Sylaj B.I –Suharekë” ka qenë i rekomanduar për kontratë, ku **ekspertja shqyrtuese** ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.1063/2025, të datës 12.11.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.1063/2025, të datës 20.11.2025, ku është arritur pajtimi në mes palëve, ndërsa tani ky OE ka parashtruar ankesë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60 dhe 69, të LPP-së.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 04.12.2025. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1:OE ankues potencon se me datë 04.12.2025 kemi pranuar B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e që sipas Autoritetit Kontraktues jemi eliminuar nga gara me arsyetimin se: Ju mungojnë

1. Pika c - Ngarkues me goma max 5 ton, minimumi 1 copë (Operatorit i mungon librezë valide dhe dokumentet përcjellëse për paisjen e kërkuar)

2. Pika d - Greder min 14 - 16 ton min. 1 copë (Operatorit i mungon librezë valide dhe dokumentet përcjellëse për paisjen e kërkuar).

AK me datë 24.11.2025 përmes sistemit e-prokurimi ka kërkuar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit (sjellja dëshmime) e që në këtë kërkesë janë kërkuar sqarim për këto dy pajisje.

OE ankues konsideron se në mënyrë të kundërligjshme është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT). Më tej, OE ankues shton se AK për plotësim kriteri ashtu dhe në Dëshmia e kërkuar dokumentare ka bërë lëshime të vogla teknike, e që këto lëshime teknike e bëjnë të pamundur dëshminë sipas kërkesave dhe nëse këto lëshime teknike i keni lënë të vetëkuptueshme nga OE, atëherë, është mëse e kuptueshme se Makineria e Rëndë ndërtimore në Republikën e Kosovës nuk dëshmohet me dokument të regjistrimit por me DUD Doganor ose Faturë (bazuar në praktikën e AK të tjerë në Kosovë).

Si fillim AK ka kërkuar që: Nga pika (a-e) të dëshmohej me dokument të regjistrimit. A mund ta specifikoni se ku është pika "e" tek pjesa e "Mundësi teknike dhe profesionale" siç ju e keni emërtuar. A është "lëshim teknik", apo është e kuptueshme se pika "e" duhet të gjendet diku aty.

Tek kërkesat e "Mundësi teknike dhe profesionale" për pikën j. Rul për ngjeshje të dheut min 13t min 1 copë dhe për pikën k. Cilinder min 5. min 1 NUK është kërkuar fare "Dëshmia e kërkuar dokumentare". A është edhe ky "lëshim teknik" sepse janë kërkuar të dëshmohej vetëm pikat nga (f-l). Bazuar në këtë si më sipër, si tek kërkesa e "Mundësi teknike dhe profesionale" ashtu dhe "Dëshmia e kërkuar dokumentare" kanë gabime teknike që e bëjnë të pamundur plotësimin e këtij kriteri.

Në lidhje me eliminimin për dëshminë e pajisjeve ju sqaroj se: a. Për sqarimin e kërkuar për pajisjen për pikën c. Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë ju sqaroj se:

Ne me rastin e tenderimit kemi dëshmuar se i posedojmë 2 ngarkues sipas kërkesës specifike

të makinerisë: 1. Kramer Allrad Radler 308/318 pronë e anëtarit të konzorciumit dhe 2. Gehl - 4610 dhe ky pronë e anëtarit të konzorciumit. Këto pajisje ndërtimore, ashtu si dhe pajisjet tjera ndërtimore në Kosovë vihen në punë pa Libreza të Qarkullimit, sepse nuk janë pajisje që qarkullojnë në rrugë por vetëm në vend punishte, dhe deri aty transportohet me Rimorkio adekuate për transport.

b. Ne lidhje me kërkesën sipas Letër Standarde për sqarimin e tenderit për pikën d. Greder

min 14-16ton min. 1 copë ju sqaroj se: Ne me rastin e tenderimit kemi dëshmuar se i posedojmë 1 Greder sipas kërkesës specifike të pajisjes: 1. CATERPILLAR 12G (pajisje kjo e huazuar nga MIRUSHA). Kjo pajisje ndërtimore, ashtu si dhe pajisjet tjera ndërtimore në Kosovë vihen në punë pa Libreza të Qarkullimit, sepse nuk është pajisje që qarkullojnë në rrugë por vetëm në vend punishte, dhe deri aty transportohet me Rimorkio adekuate për transport.

Pra, për këto 2 pajisje ne kemi dorëzuar dëshmi të cilat kërkohen standard bazuar në praktikat e AK të tjerë në Kosovë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1.Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se për pajisjet e kërkuara në:

1. Pika c - Ngarkues me goma max 5 ton, minimumi 1 copë dhe

2. Pika d - Greder min 14 - 16 ton min. 1 copë

Nuk ka dorëzuar libreza valide siç janë kërkuar shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sipas shkresave të lendes AK me datë 24.11.2025, përmes letrës standarde për sqarim të tenderit, i është drejtuar OE ankues duke kërkuar që, brenda afatit prej dy ditësh të dorëzojë dokumentet e kërkuara, në të kundërtën do të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se në dokumentet e dorëzuara nga OE ankues përmes sistemit të e-prokurimit nuk ka has në dëshmitë e kërkuar nga AK.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues përmes ankesës potencon se ne dosje të tenderit konkretisht tek kërkesat e përcaktuara nga AK ka lëshime të vogla teknike e që këto lëshime

teknike e bëjnë të pamundur dëshminë sipas kërkesave dhe nëse këto lëshime teknike i keni lënë të vetëkuptueshme nga OE, atëherë, është mëse e kuptueshme se Makineria e Rëndë ndërtimore në Republikën e Kosovës nuk dëshmohet me dokument të regjistrimit por me DUD Doganor ose Faturë (bazuar në praktikën e AK të tjerë në Kosovë), po ashtu “këto pajisje ndërtimore, ashtu si dhe pajisjet tjera ndërtimore në Kosovë vihen në punë pa Librezë të Qarkullimit, sepse nuk janë pajisje që qarkullojnë në rrugë por vetëm në vend punishte, dhe deri aty transportohet me Rimorkio adekuate për transport”.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2.Ekspertja shqyrtuese sqaron se këto dy pajisje të kontestuara, bazuar në këtë aktivitet të prokurimit, janë të regjistruara nga operatorë të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në të njëjtin tender, çka dëshmon se kërkesa e Autoritetit Kontraktues është e realizueshme . Po ashtu, OE ankues dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë, për kërkesat që mund të kenë qenë të paqarta apo të vështira për t’u përmbushur, kanë pasur mundësinë ligjore për t’i kontestuar ato gjatë fazës së sqarimit të Dosjes së Tenderit, sipas dispozitave të LPP-së. Duke qenë se kjo nuk është bërë në atë fazë të procedurës, vlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit, pretendimi i OE ankues rezulton i pa bazuar.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit kane dorëzuar ankesë pranë OSHP-së, dy (2) operatore ekonomik, ankesa me numër të protokollit NR. 2025/1219 dhe 2025/1258. Sa i përket kësaj ankese Nr. 2025/1258, ekspertja shqyrtuese konsideron se ankesa është e pa bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Komuna e Shtimes, ta kthej lenden në rivlerësim, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues “Ermal Sylaj B.I” - Suharekë, të refuzohet si e pa bazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Ermal Sylaj B.I.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes”** me numër të prokurimit: **“617-25-8164-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME**

--

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Ermal Sylaj B.I.**



Majlinda Bedrolli